

PROPOZIM

STATUTI
I NDËRMARRJES KOMUNALE PUBLIKE
“ HIGJIENA ”

Deçan ____ / ____ / 2015

Bazuar në dispozitat e nenit 11, nenit 12.2 shkronja d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (“ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës ”, Nr.28/2008), në mbështetje të Ligjit Nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe Ligjit Nr.04/L-006 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.02/L-123 për Shoqërit Tregtare, Rregullores Nr 02/2013 mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe nenit 14 pika 22 Statutit të Komunës së Deçanit Nr. 01/V-02-2010. Kuvendi Komunal i Deçanit me dt _____ miratoi :

STATUTI

I NDËRMARRJES KOMUNALE PUBLIKE

“HIGJIENA”

KAPITULLI I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Më këtë Statut përcaktohen çështjet themelore të organizimit dhe veprimtarisë së Ndërmarrjes Publike Komunale “ HIGJENA ” si Shoqëri Aksionare (në tekstin e mëtejshëm: Shoqëria Aksionare “Higjiena”.

Neni 2

Shoqërinë Aksionare “Higjiena ” e themelon Kuvendi i Komunës së Deçanit :në tekstin e mëtejshëm: Themeluesi.

Neni 3

Aktet themelore të Shoqërisë Aksionare për Organizimin, veprimtarinë, raportet e brendshme dhe me personat e tretë janë: “Marrëveshja e Themeluesit” dhe “Statuti” ndërsa aktet tjera janë: rregulloret, udhëzimet, vendimet etj.

Neni 4

4.1. Statutin e Shoqërisë Aksionare e miratojnë themeluesi respektivisht Komisioni i Aksionarëve në mbledhjen e tyre themeluese.

4.2. Aktet tjera: Rregulloret, Udhëzimet, Vendimet etj. të cilat i nxjerre Shoqëria Aksionare “Higjiena”, duhet të jenë në harmoni me Statutin .

4.3. Rregulloret dhe udhëzimet nga veprimtaria e Shoqërisë Aksionare "Higjiena", propozohen nga Bordi i Drejtorëve dhe miratohen nga Komisioni i Aksionarëve në Mbledhjen e Përgjithshme.

4.4. Vendimet i nxjerrë Bordi i Drejtorëve i Shoqërisë Aksionare " "

4.5. Statuti dhe rregulloret e Shoqërisë Aksionare "Higjiena" ndryshohen dhe plotësohen sipas procedurës së përcaktuar në nenin 36 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr. 02/L-123.

Neni 5

Të gjitha aktet e SHA duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare Nr. 02 /L-123. Në qoftë se ndonjë nga dispozitat e akteve të SHA :Statuti etj. nuk janë në harmoni me dispozitat e Ligjeve të lartpërmendura, atëherë do të aplikohen drejtpërsëdrejti dispozitat ligjore.

Neni 6

SH A. është e themeluar për kohë të pacaktuar.

Neni 7

Organet e SHA janë : Komisioni i Aksionarëve dhe Bordi Drejtorve,

KAPITULLI II

EMERTIMI DHE SELIA E SHOQERISE AKSIONARE

Neni 8

Emërtimi i Ndërmarrjes Publike është : Shoqëria Aksionare "Higjiena" .

Neni 9

Selia Qendrore e Shoqërisë Aksionare është në Deçan: Ndërtesa e Komunës së Deçanit në rrugën "Mentor Tolaj" pa nr.

Neni 10

Shoqëroja Aksionare "Higjiena" e ka Agjentin (përfaqësuesin) e vet të regjistruar të cilin me Vendim të veçantë e emëron Themeluesi i Ndërmarrjes.

Neni 11

Për ndryshimin e emërimit të Shoqërisë Aksionare, Shenjës dalluese dhe eventualisht të selisë, vendos themeluesi i saj në mbledhjen e përgjithshme të Bordit të Drejtoreve.

KAPITULLI III

VEPRIMTARIA E SH. A

Neni 12

Veprimtaria dhe aktivitetet e Shoqërisë Aksionare janë :

1. Veprimtaria dhe aktivitetet kryesorë: (3811)- Grumbullimi i Mbeturinave jo të rrezikshme
2. Veprimtaria dhe aktivitetet dytësore : (3821)- Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme

KAPITULLI IV

STATUSI FORMA DHE ORGANIZIMI I SH. A

Neni 13

SHA është Person Juridik e cili për detyrimet e veta përgjigjet me tërë pasurin e vetë

Neni 14

14.1. Forma e organizimit i shoqërisë aksionare më për së afërmi dhe në mënyrë të plotë do të përcaktohet me rregullore të posaçme dhe me akte tjera normative të brendshme të cilat duhet të jenë në harmoni me statutin e ndërmarrjes.

14.2. Për formën organizative vendos Bordi i Drejtoreve të ndërmarrjes pas konsultimit dhe pëlqimit paraprak të Komisionit Komunal të Aksionarëve.

14.3. Organizimi i saj përcaktohet konform kërkesave bashkëkohore të organizimit në bazë të nevojave për afarizëm të suksesshëm dhe synimet e zhvillimit për periudhe ardhshme.

14.4. Organizimi i SH. A përcaktohet me rregullore të brendshme duke pasur parasysh synimet e zhvillimit ekonomik për periudhën e ardhshme dhe në pajtim me këtë statut.

14.5. Për ndryshimet lidhur me SH. A organizimin e saj, karakterin, bashkimin, ndarjen e saj në pjesë më të vogla vendos Komisioni i Aksionarëve pas propozimit të Bordit të Drejtorëve.

14.6. Procedurën për ndërrimin e formës së organizimit të punës së SH. A mundë ta inicojë Bordi i Drejtorëve, një Drejtor i Bordit në bazë të propozimit me shkrim dhe aksionari apo Komisioni i Aksionarëve.

KAPITULLI V

KAPITALI THEMELOR I “SH.A”, AKSIONET E SAJ DHE AKSIONARËT

Neni 15

Kapitali themelorë i SHA është caktuar me Vendimin mbi themelimin e ndërmarrjes në lartësi prej 10.000 € (dhjetë mijë euro) dhe përbëhet nga aksionet me numër të përgjithshëm prej 100 aksionesh me vlerë nominale 10 € për një aksion.

Neni 16

16.1. Themelues i ndërmarrjes “Higjiena” SHA është Komuna e Deçanit me kapital publik, sipas Vendimit të Kuvendit Komunal për Themelimin e Ndërmarrjes Publike “Higjiena” si SHA me Vendimin 01 nr. 01/1213-14 të datës 05.06.2015.

Neni 17

16.2. Themeluesi, të drejtat e veta do ti ushtroj nëpërmes Komisionit Komunal të Aksionarëve, komision ky i formuar sipas nenit 5 (5.2) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, me date _____vendim _____.

Neni 18

Lista e Aksionarëve apo Komisioni Komunal i Aksionarëve të SHA “Higjiena” janë:

1. Komuna e Deçanit – Kuvendi Komunal i Deçanit

Neni 19

19.1 Kapitalin themelorë të SH. A e përbënë vlera e përgjithshme nominale e aksioneve të emetuara fillimisht ashtu siç është parashikuar në dokumentet e themelimit.

19.2. Kapitali themelorë përfaqëson sasinë minimale të pasurisë e cila gjithmonë do të jetë e pranishme për përballimin e detyrimeve të SH. A ndaj kreditorëve.

Neni 20

Pesëdhjetë për qind (50%) e kapitalit themelorë duhet ti paguhet ndërmarrjes para regjistrimit të SH. A. Pjesa tjetër e kapitalit themelorë e deklaruar me dokumentet e themelimit duhet të paguhet në afatin brenda një viti nga data e regjistrimit.

Neni 21

21.1. Në SH. A të drejtën e shpërndarjes së aksioneve e kanë vetëm aksionarët dhe atë vetëm brenda Shoqërisë.

21.2. SH. A mundë ta bëjë zvogëlimin e kapitalit me vendim të komisionit komunal të aksionarëve duke e zvogëluar vlerën nominale ose duke tërhequr një pjesë të aksioneve të mbetura.

21.3. SH. A. nuk mundë të emetoj aksione vlera e të cilave është më e ulët se vlera nominale.

21.4. SH. A. mundë ti tërheqë dhe ti anuloj aksionet e emetuara në rastet kur për këtë vendos themeluesi gjegjësisht komisioni komunal i aksionarëve.

KAPITULLI VI

SHPËRNDARJET- DIVIDENDET

Neni 22

22.1. Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes mundë të deklarojë dhe paguaj dividendë në ç'do kohë pas autorizimit të marr në formë vendimi nga Komisioni Komunal i Aksionarëve.

23.2. Shpërndarja (dividendës, blerja e aksioneve të veta dhe pro rata, kufizimet në shpërndarje) do të bëhen sipas procedurave të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

KAPITULLI VII

ORGANET E NDËRMARRJES “HIGJENA” SH. A.

Neni 23

Organet e ndërmarrjes “Higjiena” SH. A, janë Komisioni Komunal i Aksionarëve dhe Bordi i Drejtorëve.

Neni 24

Kompetencat e Komisionit Komunal të Aksionarëve

- 24.1. Komisioni Komunal i Aksionarëve vepron në emër të Komunës.
- 24.2. Të aprovoj ndryshoj apo plotësoj statutin dhe rregulloret e shoqërisë
- 24.3. Miratimin e deklaratave financiare vjetore të shoqërisë.
- 24.4. Mbikëqyrjen e veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve.
- 24.5. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorëve të Ndërmarrjes dhe vendosë për lartësinë e kompensimit.
- 24.6. Cakton Komisionin e Auditimit sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike
- 24.7. Merr vendim apo autorizon bordin e drejtorëve për shpërndarjen e dividendës.
- 24.8. Themelon këshillin për likuidimin e shoqërisë Aksionare.
- 24.9. Raporton së paku dy here në vite para autoriteteve komunale sipas”Marrëveshjes së Themelimit”.

Neni 25

Komisioni Komunal i Aksionarëve kryen punë dhe detyra që përcaktohen me këtë statut dhe me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 26

- 26.1. “Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve” është organi më i lartë i shoqërisë. Vendimet e mbledhjes së përgjithshme janë obliguese dhe si të tilla janë detyruese për të gjitha organet e shoqërisë.
- 26.2. Shoqëria mbanë mbledhje vjetore të Aksionarëve e cila njihet si” Mbledhje Vjetore”
- 26.3. Mbledhja Vjetore e Aksionarëve do të mbahet më së largu 60 ditë pasi bordi të marrë raportin e audituar financiar për secilin vit financiar por jo më shumë se 90 ditë pas përfundimit të vitit financiar.

26.4. Data e saktë dhe procedurat rreth mbajtjes së Mbledhjes Vjetore në pajtim me dispozitën e paracekur do të përcaktohen me rregullore të veçantë.

Neni 27

27.1. Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Aksionarëve mbahen sipas dispozitave të Nenit 190 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

27.2. Mbledhjet e jashtëzakonshme mbahen edhe me kërkesën e pronarit (Autoriteteve Komunale).

Neni 28

Mbledhjet e Aksionarëve sipas Urdhrit të Gjykatës mbahen sipas dispozitave të Nenit 191 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

29

Bordi i Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes “Higjiena” SHA ,ka autorizimet e plota të menaxhoi me veprimtarinë afariste të shoqërisë.

Neni 30

30.1. Bordi i Drejtorëve të “SHA” përbëhet nga pesë Drejtor siç është përcaktuar në “Ligjin për Ndërmarrjet Publike” dhe “Ligjin për Shoqëritë Tregtare”

30.2. Dy Drejtor zgjidhen nga komisioni komunal i aksionarëve me mandate tre vjeçar, kurse njërin drejtor që njëherit është edhe Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes “Higjiena ” SHA e zgjedhë Bordi i Drejtorëve.

30.3. Kryesuesin e bordit e zgjedhë vetë bordi i drejtorëve me shumicë të votave

30.4 Sipas dispozitave të këtij statuti nuk do të ketë Bord të Parë të Drejtorëve.

Neni 31

Bordi i Drejtorëve përbëhet nga:

1. _____ Anëtarë Anëtarë

2. _____ anëtarë Drejtor

5. _____ anëtarë Kryeshef Ekzekutiv.

Neni 32

32.1. Kompetencat e Bordit të Drejtorëve përfshijnë marrjen e vendimeve mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e ndërmarrjes, përveç atyre që u janë rezervuar në formë ekskluzive aksionarëve në këtë Statut.

32.2. Miratimin e planeve gjithëpërfshirëse afariste strategjike të shoqërisë.

32.3. Konvokimin e mbledhjeve vjetore dhe të jashtëzakonshme të aksionarëve dhe përgatitjen e agjendës fillestare.

32.4. Miratimin e raportit vjetorë të shoqërisë, raportin e bilancit vjetor dhe vlerësimeve vjetore të fitimeve dhe humbjeve të cilat do të dorëzohen te aksionarët për miratim.

32.5. Punësimin e zyrtarëve dhe menaxherëve të ndërmarrjes, lartësinë e kompensimit të tyre në marrëveshje me auditorin e "SHA" (Deklarata e Auditimit)

32.6. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që së paku një herë në vit të bëhet auditimi nga një auditor i pavarur zgjedhja e të cilit do të bëhet me miratimin e aksionarëve sipas Ligjit për Auditimin, raporti do të dërgohet komisionit të aksionarëve dhe është në dispozicion për bordin e drejtorëve dhe zyrtarët e ndërmarrjes.

32.7. Bordi i Drejtorëve sigurohet që raporti vjetor të përmbajë një deklaratë për auditimin e pavarur të gjendjes financiare, një raporte për veprimtarinë e zyrtarëve të shoqërisë I nënshkruar nga Kryesuesi i Bordit dhe së paku një Drejtor, raport i cili ju shpërndahet të gjithë drejtorëve, zyrtarëve dhe Komisionit Komunal të Aksionarëve.

32.8. Bordi i Drejtorëve mund të ngritë edhe komisione, komision obligativ është Komisioni i Auditimit të Brendshëm

32.9. Çështjet që janë në kompetencën ekskluzive të Bordit të Drejtorëve nuk mund të barten apo të vendosen nga personat tjerë ose organet tjera të shoqërisë.

Neni 33

Zgjedhja e drejtorëve, Mandati i tyre, dorëheqja dhe shkarkimi i tyre do të bëhet sipas kriterëve të përcaktuara në dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjes Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 34

Bordi i Drejtorëve mbanë mbledhje të rregullta, konvokimi i mbledhjeve, kuorumi dhe procesverbalet do të rregullohen me rregullore të brendshme të Shoqërisë.

Neni 35

Komisioni i Auditimit të brendshëm funksionin e tij do ta kryej në bazë të nenit 25 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe ligjit për Auditimin e Brendshëm.

Neni 36

Zyrtarët e Ndërmarrjes

Bordi i Drejtorëve të ndërmarrjes do të punësojë zyrtarë dhe menaxherë të lartë të ndërmarrjes që i raportojnë dhe janë nën drejtimin e Bordit të Drejtorëve.

Neni 37

36.1 Bordi i Drejtorëve emëron zyrtarin kryesor “Kryeshefin Ekzekutiv” që njëkohësisht është edhe antarë i bordit drejtues

36.2. Bordi Drejtues punëson një zyrtarë që është përgjegjës për regjistrimin e të dhënave dhe veprimet e komisionit komunal të aksionarëve dhe bordit të drejtorëve në një libër që mbahet për këtë qëllim ky zyrtarë njihet si “Sekretar i Ndërmarrjes”

Neni 38

Kompetencat e “K. SH. E-së dhe Sekretarit” përshkruhen me rregullore të brendshme.

KAPITULLI VIII

SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I “SHA”

Neni 39

Shoqëria mundë të shpërbëhet në këto rrethana:

1. Në mënyrë vullnetare me vendim të themeluesit.
2. Në mënyrë të detyrueshme në këto raste
 - a). në rast të mos dorëzimit të raportit vjetor.
 - b). sipas urdhrit të gjykatës kompetente.
 - c). në rastet kur nuk ka aftësi pagese apo falimentimit sipas procedurave të falimentimit dhe
 - d). nëse vlera e pasurisë neto shoqërisë pas vitit të dytë apo cilitdo vit pasues është më e vogël se kapitali themeltar i saj.

Neni 40

Shpërbërja dhe Likuidimi i shoqërisë bëhet konformë procedurave të aplikueshme të definuara në Ligjin për falimentim dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

KAPITULLI IX

Dispozitat Përfundimtare

Neni 41

Rregulloret e brendshme të Ndërmarrjes “Higjena” SHA do të nxjerrën në harmoni dhe pajtim me dispozitat e këtij Statuti ,që do ti trajtojnë çështjet funksionale organizative në mënyrë konkrete.

Neni 42

“SHA” ka të drejtë ti qaset në çdo kohë plotësimit dhe ndryshimit të Statutit sipas procedurave të parapara me Ligj.

Neni 43

Për te gjitha qeshjet te cilat nuk janë te rregulluara me këtë Statut,aplikohen drejtepersedrejt dispoziat e Ligjit për Ndërmarrjet publike dhe te Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Neni 44

Ky statut hynë në fuqi me datën _____ duke u miratuar nga themeluesi në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve.

Deçan ____ / ____ / 2015

Komisioni Komunal i Aksionarëve